



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202301073/7

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** *Rekomandim për zbatimin me rigorozitet të kërkesave ligjore nga strukturat vendore të policisë, për plotësimin e saktë të regjistrit të të shoqëruarve, arrestuarve/ndaluarve në mjediset e policisë, kryesisht të rubrikës për evidentimin e "përshkrimit të pamjes së jashtme dhe shenjave të vecanta" që konstatohen tek personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, në momentin e hyrjes në mjediset e Policisë së Shtetit, si dhe detyrimin për instalimin e sistemit të kamerave të sigurisë në këto mjedise dhe përcaktimin në aktet nënligjor të një a.fati të arsyeshëm ligjor për ruajtjen e pamjeve filmike të kamerave që monitorojnë veprimet e kryera nga punonjësit e policisë brenda këtyre mjediseve.*

**Drejtuar:** **Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU**  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

**TIRANË**

*I nderuar z. Rrumbullaku,*

Më lejoni t'ju falenderoj për bashkëpunimin e deritanishëm midis dy institucioneve, si dhe të vlerësoj angazhimin tuaj dhe të strukturave të Policisë së Shtetit në nivel qëndror dhe vendor, në mbrojtjen dhe garantimin e lirive e të drejtave të njeriut dhe në veçanti, në respektimin e të drejtave për personat që u privohet liria në mjediset e Policisë së Shtetit.

Në vijim, ju njohim me konkluzionet e hetimit administrativ, që institucioni i Avokatit të Popullit zhvilloi për verifikimin e "*Raportim i deklarimit të personit të ndaluar Sajmir Ibrahim, për ushtrim dhune në Komisaratin e Policisë Sarandë*" dërguar Avokatit të Popullit, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me Nr.61005-01017-23-23/246 Regj.Them., datë 16.11.2023.

Sipas procesverbalit të këtij raporti, Gjyqtari i Hetimeve Paraprake (GJHP) në çelje të seancës gjyqësore në datë 16.11.2023, për vleftësimin e masës së sigurimit personal të

personit të ndaluar Sajmir Ibrahimimi për veprën penale “Vjedhje” e kryer në bashkëpunim, pasi ka verifikuar prezencën e palëve në seancë gjyqësore, ka pyetur të ndaluarin në lidhje me respektimin e të drejtave ligjore gjatë kohës së ndalimit në mjediset e policisë. Në përgjigje të pyetjes të GJHP-së, shtetasi i lartpërmendur ka deklaruar se **“jam dhunuar në komisarariat dhe kam shenja në fytyrë”**. Në lidhje me këtë fakt, GJHP ka vendosur që **“do t’i drejtohem Avokatit të Popullit për të verifikuar rastin”**.

Institucioni ynë, me vënien në dijeni të vendimit të Gjyqtarit të Hetimeve Paraprake (GJHP) pranë gjykatës Sarandë, ka kryer regjistrimin e rastit dhe ka filluar menjëherë procedurën e hetimit administrativ, për verifikimin e faktit të ngritur nga shtetasi Sajmir Ibrahimimi *“për ushtrim dhune nga punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë”* (gjatë qëndrimit në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë), të deklaruar në seancën gjyqësore për vleftësimin e masës së sigurimit personal.

Me shkresën K4/GJ3-2 prot., datë 21.11.2023, institucioni i Avokatit të Popullit iu drejtua DVP-së Vlorë dhe Komisarariatit të Policisë Sarandë, me kërkesën për dërgimin (brenda një afati të arsyeshëm) të një informacioni për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit që vërteton veprimet e kryera nga punonjësit e policisë me këtë shtetas gjatë kohës së qëndrimit të tij në mjedisin e shoqërimit dhe të sigurisë si: a) kopje të regjistrit të të shoqëruarve; b) kopje të regjistrit me të dhënat për personat e arrestuar/ndaluar; c) CD me pamjet filmike të kamerave të sigurisë që monitorojnë dhe mbajnë në vëzhgim këto ambiente; d) kopje të regjistrit të kërkesë/ ankesave; si dhe çdo informacion dhe dokumentacion tjetër që ka të bëjë me sqarimin e pretendimit të paraqitur në seancë gjyqësore nga shtetasi Saimir Ibrahimimi.

Duke vlerësuar rëndësinë e çështjes dhe me qëllim kryerjen e një hetimi të thelluar, institucioni i Avokatit të Popullit ngriti edhe një grup pune me ekspertë të MKPT-së (Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, seksion pranë Avokatit të Popullit), me qëllim këqyrjen në vend dhe administrimin e dokumentacionit ku pasqyrohen të dhënat e shtetasit Sajmir Ibrahimimi, si dhe veprimet e kryera nga punonjësit e policisë të komisarariatit gjatë shoqërimit dhe qëndrimit në dhomat e sigurisë. Qëllimi i grupit të punës ishte gjithashtu dhe kryerja e intervistimit të shtetasit Sajmir Ibrahimimi, familjarëve të tij dhe punonjësve të policisë që kanë dijeni për ngjarjen, si dhe këqyrjen e pamjeve filmike të ruajtura nga sistemi i kamerave të sigurisë të vendosura në mjediset e brendshme të këtij komisarati.

## **I - Veprimet e kryera nga grupi i ekspertëve:**

1. Në datë 05.12.2023 grupi i ekspertëve zhvilloi një takim me drejtuesit e Komisarariatit të Policisë Sarandë dhe mori një informacion paraprak në lidhje me sqarimin e rrethanave të çështjes së sipërpërmendur. Nga informacioni rezultoi se:  
*“Shtetasi Sajmir Ibrahimimi është shoqëruar në mjediset e policisë në datë 13.11.2023, si person i dyshuar për veprën penale të “Vjedhjes”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal dhe ka qëndruar në dhomat e sigurisë deri në datën 16.11.2023, datë kur është paraqitur në gjykatë për vleftësimin e masës së sigurimit*

personal. Ky shtetas nuk është dhunuar në asnjë moment dhe nga asnjë prej punonjësve të policisë të këtij komisariati. Në momentin e shoqërimit është e vërtetë se **ky shtetas ka patur një plagë në pjesën e sipërme të hundës**, plagë e shkaktuar para se të hynte në ambientet e komisariatit dhe kjo e vërtetuar nga pamja e fotografisë së tij gjatë paraqitjes për njohje dhe marrjes së shenjave të gishtave.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë në përfundim të seancës për vleftësimin e masës së sigurisë, ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të personit në hetim dhe ka vendosur masën e sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore dy herë në muaj”. Aktualisht ky shtetas ndodhet pranë familjarëve të tij.

Në lidhje me pretendimin e ngritur në seancën gjyqësore nga shtetasi Sajmir Ibrahimimi “për ushtrim dhune nga punonjësit e policisë të komisariatit në Sarandë”, jemi në dijeni se, **Prokurori i çështjes ka filluar menjëherë hetimin penal** në lidhje me këtë deklaram të tij. Ai ka urdhëruar OPGJ për të marrë paraprakisht deklaratat personale të shtetasve Sajmir Ibrahimimi dhe babait të tij Përparim Ibrahimimi. Nga sa jemi në dijeni, këta shtetas kanë deklaruar në prokurori se “nuk jemi dhunuar nga punonjësit e policisë”. Megjithatë, konkluzionin për këtë çështje, do ta japë organi i prokurorisë në përfundim të hetimit”.

2. Në vijim të procedurave, grupi i ekspertëve verifikoi regjistrat në zyrën e informacionit dhe zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë të komisariatit, ku pasqyrohen të dhënat për personat e shoqëruar, arrestuar apo të ndaluar në mjediset e policisë. Nga këqyrja e regjistrave u konstatua se, rubrika ku evidentohet “**përshkrimi i pamjes së jashtme (përfshi dhe shenjat e veçanta)**”, për personat kur hyjnë në dhomat e shoqërimit dhe më tej, ata kalojnë në dhomat e sigurisë, nuk ishte plotësuar në mënyrë rigoroze sipas kërkesave që parashikohen në procedurat standarde, pasi **nuk** kishte asnjë të dhënë për shenjat e veçanta në pamjen e jashtme të shtetasit Sajmir Ibrahimimi. Referuar regjistrave, në këtë rubrikë ishte bërë shënimi “**Normal**” ndërkohë që shtetasi Sajmir Ibrahimimi, para se të paraqitej në seancën gjyqësore për vleftësimin e masës së sigurimit personal, ka qëndruar në mjediset e komisariatit të policisë me masë sigurie “arrest me burg” dhe ka patur dëmtime në fytyrë.
3. U verifikuan shënimet në regjistrin e kërkesë/ankesave që ndodhej në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë dhe rezultoi se në asnjë nga regjistrat, **nuk** kishte të shënuar asnjë kërkesë apo ankesë nga shtetasi Sajmir Ibrahimimi, për ushtrim dhune nga punonjës të policisë të këtij komisariati.
4. Grupi i ekspertëve kërkoi të bëjë këqyrjen e pamjeve filmike të ruajtura nga sistemi i kamerave të sigurisë, të vendosura në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë të komisariatit. Nga konstatimi i ekspertëve dhe sipas informacionit të drejtuesve të policisë, në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë ishin instaluar 3 (tre) kamera sigurie, si një donacion i një subjekti privat. Afati i ruajtjes së pamjeve filmike të kamerave të sigurisë ishte deri në 5 (pesë) ditë, pasi kapaciteti i serverit ishte i vogël. Në këto kushte, **nuk** u bë e mundur këqyrja e pamjeve filmike, pasi në datën 16.11.2023 me vendim të gjykatës, shtetasit Sajmir Ibrahimimi i është

vendosur masa e sigurimit personal “Detyrim paraqitje” dhe është larguar nga mjediset e komisariatit.

5. Për intervistimin e shtetasit Sajmir Ibrahim, grupi i ekspertëve komunikoi me babain e tij Përparim Ibrahim (pasi djali tij ishte i sëmurë në efektin e ilaçave, si përdorues i lëndëve narkotike), i cili iu përgjigj menjëherë kërkesës për takim në ambientet e Komisarariatit të Policisë Sarandë. Dëshmia e tij është pasqyruar në një procesverbal të mbajtur në datë 05.12.2023 nga grupi i ekspertëve dhe ndodhet në dosjen e hetimit administrativ për këtë rast.

Në dëshminë e tij, shtetasi Përparim Ibrahim deklaroi se:

*“Djali i tij Sajmiri është shoqëruar në Komisarariat e Policisë Sarandë në datë 13.11.2023, për veprën penale të “vjedhjes” dhe në datë 16.11.2023, gjykata vendosi masën e sigurimit personal “detyrim paraqitje”. Djali ka probleme të thella familjare, pasi është i divorcuar dhe aktualisht ish-bashkëshortja dhe fëmijët e tij janë larguar pa “dhënien e pëlqimit” për në Greqi. Ndodhur në këto kushte, ai ka filluar përdorimin dhe është nën efektin e lëndëve narkotike. Jam kthyer nga emigacioni vetëm për t’i qëndruar afër djalit tim, i cili ka filluar të marrë mjekim sipas rekomandimit të mjekut. Djali im **nuk është dhunuar** nga punonjësit e policisë së këtij komisariati. Shenjat në fytyrë janë të disa ditëve para se të shoqërohej për në komisarariat, pas një zënie (grindje) me disa persona në datë 08.11.2023 (para banesës ku banojmë), duke qenë i papërgjegjshëm dhe nën efektin e lëndëve narkotike. Nga tani e në vazhdim, djali im do të jetë nën mbikqyrjen dhe kujdesin tonë si prindër”.*

6. Drejtuesit e komisariatit vunë në dispozicion një foto të shtetasit Sajmir Ibrahim në momentin e paraqitjes për njohje dhe marrjen e shenjave të gishtave. Në foto është e dukshme një **plagë në pjesën e sipërme të hundës**, e cila nuk është e pasqyruar në asnjë nga regjistrat dhe librat e shërbimit që administrohen në këtë komisarariat.
7. Nga këqyrja e kartelës mjekësore që plotësohet nga mjeku i institucionit brenda 12 orëve të para të arrestimit/ndalimit të personit, **nuk** ka të shënuar asnjë shenjë të veçantë që të dallohet në pjesën e fytyrës të shtetasit Sajmir Ibrahim.
8. Grupi i ekspertëve për hetimin e rastit, mori takim edhe me prokurorin e çështjes në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Në takim u informua se, në lidhje me deklarimin e shtetasit Sajmir Ibrahim në seancën gjyqësore për vleftësimin e masës së sigurimit personal, ku ndaj tij “është ushtruar dhunë në Komisarariat e Policisë Sarandë”, përfaqësuesi i organit të akuzës në këtë seancë gjyqësore, ka filluar menjëherë procedurat për hetimin penal të faktit dhe aktualisht shqyrtimi i çështjes është ende në proces. Fillimisht janë marrë dëshmitë e shtetasve Sajmir Ibrahim dhe babait të tij Përparim Ibrahim. Krahas marrjes së deklarimeve, prokurori i çështjes kishte urdhëruar: a) kryerjen e ekspertizës mjeko-ligjore, b) administrimin e regjistrave që mbahen në komisarariat dhe të pamjeve filmike të siguruara nga kamerat e sigurisë, si dhe c) fotografimin e shtetasit në momentin e kryerjes së procedurave për njohje dhe marrjes së shenjave të gishtave. Referuar dëshmive të para që janë marra nga OPGJ e organit të prokurorisë, nuk rezulton të jetë ushtruar dhunë ndaj tij nga punonjësit e policisë, por

për arsye se hetimi penal është në proces, ende nuk mund të ketë një përgjigje të saktë dhe përfundimtare.

## **II - Përsa më sipër, deri në pritje të rezultateve të hetimit penal që po kryen organi i prokurorisë, konstatojmë disa shkelje në zbatimin e kërkesave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për personat e shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar në mjediset e policisë, nga specialistë dhe punonjës të policisë në Komisarariatit të Policisë Sarandë.**

Konkretisht:

1. Shtetasi Sajmir Ibrahim **ka qenë i dëmtuar në pjesën e fytyrës**, para se të hynte në dhomat e shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Sarandë, pasi sipas deklarimeve, ai është konfrontuar në datë 08.11.2023 me dy persona pranë banesës së tij, ndërkohë që shoqërimi në komisarariat është kryer në datë 13.11.2023, duke qenë nën efektin e lëndëve narkotike. Kjo vërtetohet nga dëshmia e babait të tij Përparim Ibrahim para grupit të ekspertëve, si dhe fotografia e shtetasit Sajmir Ibrahim gjatë “Marrjes së gjurmëve daktiloskopike dhe fotografimit” të personit, para se të kalonte nga dhomat e shoqërimit për dhomat e sigurisë të komisarariatit të policisë. Në “Regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, i cili ndodhet në zyrën e informacionit, në rubrikën “*Përshkrimi i pamjes së jashtme (përfshi dhe shenja të veçanta)*”, punonjësi i policisë në këtë rubrikë ka bërë shënimin “*Normal*”, **ndërkohë që shtetasi ka qenë i dëmtuar** në pjesën e fytyrës, në momentin e hyrjes në mjediset e komisarariatit. Kjo vërtetohet nga këqyrja e “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, në datë 13.11.2023 kur është bërë shoqërimi i këtij shtetasi në mjediset e komisarariatit.
2. Në “Regjistrin për personat e ndaluar/arrestuar”, i cili ndodhet në dhomat e sigurisë, në rubrikën “*Përshkrimi i pamjes së jashtme (përfshi dhe shenja të veçanta)*”, përgjegjësi i dhomave të sigurisë ka bërë shënimin “*Normal*”, ndërkohë që në pjesën e fytyrës (sikurse është e dukshme edhe nga foto e paraqitjes për njohje), ai ka një **shenjë të dallueshme** në pjesën e sipërme të hundës. Kjo vërtetohet nga këqyrja e shënimeve në “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e arrestuar/ndaluar” datë 13.11.2023, kur shtetasi Sajmir Ibrahim ka kaluar nga dhomat e shoqërimit në dhomat e sigurisë, si dhe nga fotografia e personit të arrestuar gjatë marrjes së gjurmëve dhe bërjes së fotografimit nga specialistë/ndihmës specialistë të komisarariatit të policisë.
3. Mjeku i institucionit (i cili është i punësuar me kohë të pjesëshme nga urgjenca e spitalit Sarandë), në “Kartelën mjekësore me shënimet përkatëse të mjekut” për personat e arrestuar/ndaluar, **nuk** ka evidentuar në kartelën mjekësore të këtij shtetasi, asnjë shenjë të veçantë të dukshme në fytyrën apo trupin e këtij personi. Kjo vërtetohet nga “Kartela mjekësore” për personin e arrestuar Sajmir Ibrahim, pjesë e fashikullit që ndodhet në arshivën e Komisarariatit të Policisë Sarandë.
4. Kamerat e sigurisë të vendosura në korridorin e dhomave të shoqërimit dhe në korridorin e dhomave të sigurisë, **nuk kanë të ruajtura pamje filmike**, të siguruara

nga kamerat e sigurisë në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë për datat 13 – 16.11.2023, pasi regjistrimet ruhen deri në 5 (pesë) ditë, për arsye se serveri ka kapacitet të ulët. Kjo është e pranuar nga Komisariati i Policisë Sarandë me shkresë nr.3996/1 prot., datë 04.12.2023 “Kthim përgjigje” dërguar Avokatit të Popullit, si dhe nga DVP Vlorë me shkresë nr.3996/2 prot., datë 04.12.2023 “Kthim përgjigje” dërguar Avokatit të Popullit.

### **III – Në përfundim të veprimeve të kryera për hetimin administrativ të rastit, nga analiza e provave dhe fakteve arrijmë në disa konkluzione:**

Në ligjin 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” miratuar me Urdhër nr.1720, datë 20.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Procedurën standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhër nr.894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, përcaktohen qartë rregullat teknike të shoqërimit, arrestimit dhe ndalimit, mënyra e evidentimit të të dhënave të personave, mbajtja, trajtimi i personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre, në ambientet e Policisë së Shtetit.

Procedura standarde e punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, kapitulli VII (Procedura të dokumentimit të veprimit të shoqërimit), thuhet shprehimisht se: *“Akti/veprimi i shoqërimit, detyrimisht evidentohet dhe dokumentohet në sistemin elektronik, në regjistra, në formularë dhe proceverbale”*.

Konkretisht, dokumentimi i të dhënave për personat e shoqëruar kryhet në “Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar”, (Lidhja model 1), si dhe në Formularin e Raportit të Shoqërimit, sipas tipit/modelit të miratuar me urdhër të DPPSH (Lidhja model 2), si pjesë të pandara të kësaj procedure pune.

Gjithashtu, në procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ ankesave të tyre”, përcaktohen qartë edhe rregullat për pranimin dhe akomodimin e të arrestuarve/ndaluarve në ambientet e dhomave të sigurisë, i cili kryhet nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, kundrejt dokumentacionit dhe kontrollit që kryen oficeri i policisë gjyqësore që ka kryer arrestimin apo ndalimin. Procedura parashikon që krahas dokumentacionit, specialisti i policisë dhe personeli i shërbimit në këto ambiente duhet të ushtrojë disa kontrole ndaj këtyre personave, të cilat nuk duhet të neglizhohen prej tyre si:

a) kontrolli personal i të arrestuarit/ndaluarit; b) kontrolli sipërfaqësor i rrobave të trupit dhe rregullat e kryerjes së tij; c) kontrolli i imët dhe rregullat e kryerjes së tij; d) kontrolli i anësive/intim dhe rregullat për kryerjen e tij. Të gjitha këto veprime dhe konstatimet nga kontrollet e kryera nga personeli i shërbimit në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë,

duhet të pasqyrohen në regjistrat, formularët dhe librat e shërbimit që janë në administrim të strukturave të policisë.

Sikurse konstatohet, plotësimi i dokumentacionit, këqyrja dhe kontrolli i personit para se ata të hyjnë në mjediset e privimit të lirisë, është detyrim ligjor i punës së funksionit specialist/ndihmës specialist për informacionin/përgjegjës për dhomat e sigurisë, në strukturën e rendit publik të komisariatit të policisë, ndaj mosplotësimi i saktë i rubrikave me të dhënat e plota të të shoqëruarve apo mungesa e tyre është përgjegjësi ligjore e tyre.

Përsa më lart, grupi i ekspertëve që zhvilloi procedurat e hetimit administrativ të rastit, ka konstatuar disa shkelje në mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit, që kanë të bëjnë me neglizhenca në ushtrimin e detyrës funksionale të punonjësve të policisë të ngarkuar me këtë detyrë. Konkretisht:

1. Nga këqyrja e regjistrat me të dhënat për personat e shoqëruar, të arrestuar/ndaluar që ndodhej në zyrën e infomacionit dhe në dhomën e përgjegjës të dhomave të sigurisë, në rubrikën “Përshkrimi i pamjes së jashtme”, ishte shënuar “**Normal**”, pa evidentuar në regjistër përshkrimin e pamjes së jashtme dhe shenjat e veçanta të shtetasit Sajmir Ibrahim, ndërkohë që në momentin e hyrjes në mjediset e Komisarariatit të Policisë Sarandë, shtetasi ka qenë me plagë në fytyrë. Në regjistrin për të shoqëruarit dhe të arrestuarit/ndaluarit gjendet një rubrikë “**Përshkrimi i pamjes së jashtme**”, në të cilën punonjësit e policisë duhet të përshkruajnë detyrimisht pamjen e jashtme dhe shenja të veçanta që mund të kenë këta persona si, “*me një dorë apo një sy, shenja djegieje apo plage, tatuazhe, nishane etj*”.

Por, nga hetimi rezultoi se, punonjësit e policisë në Komisarariatit të Policisë Sarandë që kanë kryer arrestimin në flagrancë, shoqërimin dhe më tej ndalimin në dhomat e sigurisë, **kanë neglizhuar** përshkrimin e pamjes së jashtme të shtetasit Sajmir Ibrahim dhe shenjat e veçanta të tij, duke i dhënë mundësinë personit të arrestuar dhe avokatit mbrojtës, të drejtën për t’u përdorur faktin, si masë mbrojtje në seancën gjyqësore. Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, rubrikat që përbëjnë regjistrat dhe formularët “Tip”, ku evidentohen të dhënat për personat e shoqëruar, të arrestuar/ndaluar janë qartësisht të kuptueshme dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën, me qëllim që çdo shtetas kur hyn në mjediset e policisë të jetë i evidentuar në tërësinë e të dhënave personale, duke përfshirë dhe pamjen e jashtme apo dhe shenjat e veçanta të tij.

2. Para sistemimit/akomodimit në dhomat e sigurisë, një grup me punonjës policie i nivelit të parë drejtues i shërbimeve të rendit publik, specialisti i shërbimit, ndihmës specialisti për informacionin dhe mjeku i policisë, kryejnë intervistimin, **verifikimin dhe këqyrjen e jashtme të arrestuarit/ndaluarit** nëse ka shenja të ushtrimit të dhunës, keqtrajtimit, sëmundje të ndryshme që kanë nevojë për ndihmë mjekësore apo ankesa të tjera të kësaj natyre. Në përfundim të këtij procesi, grupi i ngritur për intervistimin dhe këqyrjen e pamjes së jashtme të arrestuarit/ndaluarit, gjithçka të konstatuar e pasqyrojnë në një procesverbal verifikimi/konstatimi, i cili nënshkruhet

nga të gjithë punonjësit e policisë që janë përfshirë në verifikim/konstatim dhe vendoset në dosjen e të ndaluarit/arrestuarit.

Nga këqyrja e dosjes, u konstatua se, **nuk ishte shënuar asnjë shenjë e veçantë** në përshkrimin e pamjes të jashtme të shtetasit Sajmir Ibrahimimi.

3. Sipas procedurave standarde, çdo personi të arrestuar/ndaluar që mbahet në dhomat e sigurisë i çelet fashikulli me emrin e tij në regjistër. Një prej dokumenteve në përbërje të fashikullit, është dhe “Kartela mjekësore”, ku pasqyrohen gjendja shëndetësore e të arrestuarit/ndaluarit nga momenti i hyrjes në dhomat e sigurisë, me shënimet përkatëse të mjekut. Nga verifikimi i “Karteles mjekësore” në fashikullin e të arrestuarit Sajmir Ibrahimimi, ishte shënuar se ishte përdorues i lëndëve narkotike, por **mjeku nuk kishte të shënuar asnjë shenjë të veçantë** të identifikuar në paraqitjen e jashtme të tij. Vizitat mjekësore ndaj të arrestuarit/ndaluarit kryhen nga mjeku apo ndihmës mjekë i komisarariatit të policisë, dhe në mungesë të tyre nga mjekë të qendrave spitalore rajonale të miratuar nga shefi komisarariatit të policisë (si në rastin e Komisarariatit të Policisë në Sarandë). Por, në çdo rast kur gjatë vizitës/kontrollit konstatohen dëmtime fizike, plagë apo gjakrrjedhje, etj mjeku/ndihmës mjeku i njësisë policore dhe specialisti i shërbimeve të rendit përveç shënimeve në kartelën mjekësore dhe librat e shërbimit, duhet të marrin masa të menjëhershme për dërgimin e tij në qendrën më të afërt spitalore për t’i dhënë ndihmën e nevojshme.

Nga verifikimi i praktikës dhe dokumentacionit në këtë komisarariat, **nuk** konstatohet të jenë evidentuar apo pasqyruar nga stafi i policisë dhe mjeku, kryerja e veprimeve të parashikuara në procedurën standarde.

4. Në zbatim të kërkesave të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe ligjit 19/2016 “Për masa shtesë në sigurinë publike”, përcaktohet qartë se, subjektet publike kanë detyrimin për të vendosur sistemin e kamerave të sigurisë në ambientet e brendshme dhe të jashtme të tyre. Në këtë kuadër, legjislacioni përcakton se edhe strukturat e policisë në nivel qendror dhe vendor (DVP/komisariateve të policisë), kryesisht **në vendet e privimit të lirisë së personit, kanë detyrimin për të instaluar sistemin e kamerave audio-vizive**, si dhe të marrin masa shtesë për ruajtjen e imazheve filmike në një afat të arsyeshëm ligjor, ku për disa subjekte afati është deri në 2(dy) muaj<sup>1</sup>. Nga inspektimet periodike që ka kryer institucioni i Avokatit të Popullit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në DVP/komisariatet e policisë, ka konstatuar se jo në të gjitha këto ambiente janë të vendosura kamerat e sigurisë, ashtu si problematike është fakti se dhe në ato vende janë të vendosura sistemi i kamerave të sigurisë, afati i ruajtjes së pamjeve filmike audio-vizive në ambientet e privimit të lirisë së personit, **nuk është e standartizuar**. Policia e Shtetit ka detyrimin të identifikojë subjektet publike dhe private për marrjen e masave shtesë të sigurisë, duke

---

<sup>1</sup> Ligji 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, neni 5/3 përcakton se “Policia e Shtetit identifikon të gjitha subjektet që disponojnë dhe administrojnë sisteme të sigurisë, si kamera për regjistrim të pamjeve filmike, CCTV me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NRV/Server deri në 2 muaj...”.



përfshirë edhe ambientet e brendshme dhe të jashtme të strukturave të varësisë së saj, për instalimin e sistemit të kamerave të sigurisë, si dhe të përcaktojë një afat të arsyeshëm ligjor për ruajtjen e pamjeve filmike, sikurse është përcaktuar për subjektet publike/private në Udhëzimin nr.633, datë 06.11.2018 i Ministrit të Brendshëm “Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo të vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre”.

Mbikqyrja me kamera e mjediseve të komisariatit dhe ruajtja e pamjeve filmike (përveç atyre mjediseve ku çënohet privatësia), është vlerësuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, si një proces thelbësor për tre arsye:

*Së pari*, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

*Së dyti*, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

*Së treti*, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura.

Në lidhje me rëndësinë e vendosjes së kamerave të sigurisë në mjediset e policisë, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT), në raportin për Qeverinë Armene mbi vizitën e tij në Armeni në vitin 2019 (datë 2 deri më 12 dhjetor 2019), ka rekomanduar se: “Në të gjitha pikat hyrëse/dalëse, korridoret dhe dhomat e caktuara të marrjes në pyetje të institucioneve të policisë të pajisen me kamera CCTV... duke përfshirë edhe personelin e paraburgimit që punon në ambientet e paraburgimit të policisë dhe pajisjen e tyre me kamera trupore. Ky sistem i kamerave është në interes si të personave që mund të jenë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtim fizik ose presion psikologjik”<sup>2</sup>.

Përsa më sipër, (deri në përfundim të hetimit penal nga organi i Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Sarandë të rastit të lartpërmendur), grupi i ekspertëve të MKPT-së në përfundim të hetimit administrativ, nuk konstaton ushtrim të dhunës nga punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë ndaj shtetasit Sajmir Ibrahimimi, por shkelje të një sërë rregullash dhe procedurash ligjore që garantojnë respektimin e të drejtave dhe trajtimin e personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar.

---

<sup>2</sup> *Link: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://rm.coe.int/1680a29ba1>*

Bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”;

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për zbatimin me rigorozitet nga strukturat dhe punonjësit e policisë në nivel vendor, të kërkesave ligjore për plotësimin e saktë të rubrikave në regjistrin e të shoqëruarve, arrestuarve/ndaluarve, kryesisht në rubrikën për evidentimin e “**përshkrimit të pamjes së jashtme dhe shenjave të vecanta**” që konstatohen tek këta persona, që në momentin e hyrjes së tyre në mjediset e Policisë së Shtetit.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për **trajnimin e stafëve dhe punonjësve të policisë** që shërbejnë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në DVP/komisariatet e policisë, për garantimin e lirive dhe të drejtave për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, sipas parashikimeve në legjislacionin kombëtarë dhe standardet ndërkombëtare.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të kamerave të sigurisë në mjedisin e shoqërimit dhe të sigurisë të DVP/komisariateve të policisë, si dhe nxjerrjen e një akti nënligjor për miratimin e **skemës të vendosjes së kamerave** në mjediset e komisariateve të policisë ku privohet liria e personit dhe përcaktimin e një **afati të arsyeshëm ligjor** për ruajtjen e pamjeve filmike.

*Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,*

**KOMISIONERI**

**Ahmet PRENÇI**